



## DORACAKU I PROCEDURAVE PËR PROJEKTE ME INTERES PËR KOMUNITETIN E ENERGJISË – KOSOVË

Rregullorja e BE 347/2013 mbi udhëzimet për  
Infrastrukturën energjetike Trans-Evropiane

*Sekretariati i Komunitetit të Energjisë*

## Tabela e Përmbajtjes

I.	HYRJE.....	4
	<b>1.1 Rregullorja Nr. 347/2013 dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017</b> .....	4
	<b>1.2 Qëllimet e Rregullores</b> .....	4
	• <b>1.3 Një pikë shërbimi me një ndalesë (One-Stop-Shop)</b> .....	6
	<b>si Autoritet Kompetent në Kosovë</b> .....	6
	<b>1.4 Kompetencat e një pike shërbimi me një ndalesë (One-Stop-Shop)</b> .....	7
II.	Sfondi i procesit të dhënies së lejeve.....	7
	<b>2.1 Skema bashkëpunuese</b> .....	7
	<b>2.2 Roli i One-Stop-Shop</b> .....	8
	<b>2.3 Roli i autoriteteve për lëshimin e lejeve</b> .....	9
	<b>2.4 Detyrimet dhe kërkesat</b> .....	9
III.	DORACAKU I PROCEDURAVE .....	11
IV.	Procesi i dhënies së lejeve .....	14
	<b>4.1 Faza e njoftimit</b> .....	14
	<b>4.2 Procedura para aplikimit</b> .....	15
	<b>4.3 Procedura statutore/ligjore për dhënien e lejeve</b> .....	18
	<b>4.4 Lista e dokumenteve relevante:</b> .....	21
	<b>4.5 Marrja e vendimit gjithëpërfshirës</b> .....	21
V.	PJESËMARRJA E PUBLIKUT .....	22
	<b>5.1 Neni 9 i Rregullores nr. 347/2013 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017</b> .....	22
	<b>V.2 Procedura e para-aplikimit dhe pjesëmarrja e publikut</b> .....	22
	<b>5.3 Pjesëmarrja e publikut para dorëzimit të dosjes së aplikacionit</b> .....	23
	<b>5.4 Koncepti i pjesëmarrjes së publikut</b> .....	23
	<b>5.5 Faqja e internetit të projektit dhe pjesëmarrja e publikut</b> .....	24
	<b>5.6 Procedura statutore/ ligjore e dhënies së lejeve dhe pjesëmarrja e publikut</b> .....	25
VI.	LEGJISLACIONI RELEVANT PËR DHËNIEN E LEJEVE .....	26
	<b>6.1 Planifikimi hapësinor (mjedisor, ndërtimor dhe shpronësor)</b> .....	26
	6.1.1. Planifikimi hapësinor.....	26
	6.1.2 Leja/pëlqimi mjedisor .....	27
	6.1.3 Leja ndërtimore.....	28
	6.1.4. Shpronësimi i pronës së paluajtshme .....	28
	<b>6.2 Autorizimi për ndërtimin e infrastrukturës së re</b> .....	29

6.2.1. Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme .....	29
6.2.2. Autorizimi për ndërtimin e infrastrukturës së energjisë elektrike dhe infrastrukturës së gazit natyror .....	29
<b>6.1 Infrastruktura e gazit</b> .....	29
6.3.1. Siguria e furnizimit me gaz natyror .....	30
6.3.2. Licencimi i aktiviteteve të gazit natyror .....	30
6.3.2. Pajisjet nën presion.....	31
<b>6.2 Infrastruktura e energjisë elektrike</b> .....	31
6.4.1. Kodi i Rrjetit të Transmisionit.....	31
6.4.2. Licencimi i aktiviteteve të energjisë elektrike .....	31
VII. Palët kryesore të interesit.....	33
VIII. Hollësitë e dokumenteve për aplikime .....	34
IX. Detajet e kontaktit .....	35
<b>9.1 Autoriteti Kompetent: One-Stop-Shop</b> .....	35
<b>9.2 Autoritetet tjera*</b> .....	35

## I. HYRJJE

### 1.1 Rregullorja Nr. 347/2013 dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017

Ky Doracak Procedural për Projekte me Interes për Komunitetin e Energjisë në Kosovë është hartuar duke përdorur si dokument kryesor referues Rregulloren Nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 prill 2013, mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-evropiane. Kjo Rregullore është përshtatur dhe është miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror D/2015/09/MC-EnC (në tekstin e mëtejme referuar si: Rregullorja) në mënyrë që të ndihmojë Palët Kontraktuese në lehtësimin e implementimit të projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë. Rregullorja, së bashku me Vendimin e inkorporuar D/2015/09/MC-EnC, mund të shkarkohet [këtu](#).

Qëllimi i këtij Doracaku të Procedurave është që të sigurojë një elaborim të thellë të procedurave të cilat duhet të ndiqen nga Autoriteti Kompetent dhe autoritete të tjera përkatëse, nga Promovuesi i Projektit dhe nga secila palë tjetër e përfshirë në cilëndo formë gjatë implementimit të një projekti me interes për Komunitetin e Energjisë. Ky Doracak Procedural është i destinuar për të shërbyer si mjet udhëzues dhe do të përdoret në lidhshmëri me një sërë dokumentesh tjera ligjore, përkatësisht me legjislacionin primar dhe sekondar.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës, si autoritet përgjegjës për sektorin e energjisë në vend, ka miratuar Udhëzimin Administrativ Nr.01/2017 për Promovimin e Investimeve të Përbashkëta Rajonale në Sektorin e Energjisë (në tekstin e mëtejme referuar si: Udhëzimi Administrativ) duke i mundësuar Kosovës të jetë një nga Palët e para Kontraktuese që të shënojë një progres konkret në transpozimin ligjor të kërkesave që dalin nga Rregullorja. Udhëzimi Administrativ mund të shkarkohet [këtu](#). Në korrik të vitit 2017, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) mori vendimin për emërimin e Autoritetit Kompetent, që aktualisht është vendosur të jetë Divizioni për Standarde dhe Rregulla Teknike në kuadër të Departamentit të Energjisë pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, si organ përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve për dhënien e lejeve që kanë të bëjnë me projektet me interes për Komunitetin e Energjisë. Në thelb, Autoriteti Kompetent shërben si një pikë shërbimi me një ndalesë (One-Stop-Shop) për koordinimin e aktiviteteve në procesin e dhënies së lejeve për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë.

### 1.2 Qëllimet e Rregullores

Deri sa në përgjithësi dihet se ekziston një numër projektsh infrastrukture që janë të rëndësishme thelbësore si për BE-në ashtu edhe për Palët Kontraktuese për të arritur qëllimet e tyre drejt krijimit të një Tregu të Brendshëm të Energjisë dhe Tregut të Komunitetit të Energjisë, dhe veçanërisht, për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji, e megjithatë, investimet në përgjithësi po vonohen ose braktisen pothuajse tek të gjitha Palët Kontraktuese për shkak të procedurave të komplikuar të marrjes së lejes, për shkak të pengesave rregullore ose problemeve tjera të ndërlydhura me financimin.

Nga kjo që u cek më lartë, me qëllim të lehtësimit të zbatimit të investimeve prioritare, BE ka miratuar Rregulloren dhe përkatësisht, në sajë të Vendimit D/2015/09/MC-EnC, Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë miratoi gjithashtu Rregulloren (BE) 347/2013 me përshtatje të caktuara.

Një nga qëllimet kryesore të Rregullores është lehtësimi i procedurave të marrjes së lejeve dhe nxitja e investimeve në infrastrukturën energjetike në mënyrë që Komuniteti i Energjisë të arrijë objektivat e politikave të tija energjetike dhe mjedisore.

Rregullorja, e përshtatur për Komunitetin e Energjisë, përcakton rregulla për identifikimin e projekteve me rëndësi për Komunitetin e Energjisë, të quajtura Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë (PECI-të), pasi të jenë vërtetuar se janë të zhvilluara mjaftueshëm. Në bazë të Rregullores, do të vazhdohet me identifikimin e PECI-ve në kuadër të kategorive të energjisë elektrike, përkatësisht infrastrukturës së gazit dhe të naftës, si dhe brenda fushës tematike të njohur si “lansimi i rrjetit inteligjent”.

Këto projekte do të përfitojnë nga procedurat e lehtësuara të marrjes së lejes brenda Palëve Kontraktuese, dhe kur është e përshtatshme, nga alokimi i kostove ndërkufitare. Deri sa ne Rregullore përshkruhen tri modele për lehtësimin e procedurave të marrjes së lejeve, ligjvënësit dhe autoritetet kombëtare duhet të përzgjedhin njërin prej tyre dhe ta zbatojnë atë përmes legjislationit dhe procedurave kombëtare.

Projektet që fitojnë epitetin e një *Projekti të Interesit për Komunitetin e Energjisë* (PECI) dhe të një *Projekti të Interesit të Përbashkët* (PMI) synojnë të identifikojnë dhe kuptojnë rëndësinë ndërkufitare të një projekti, dhe si të tilla këto projekte mund të jepen me përfitime speciale. Duke e pasur statusin PECI e trason rrugën edhe për financimin e mundshëm të studimeve dhe punimeve përmes granteve nga Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimin (IPA), përkatësisht nga Fondi për Nxitjen e Investimeve në Fqinjësi (NIF) i asistencës teknike dhe financiare të Bashkimit Evropian.


Përfitimet kryesore për një projekt që e ka statusin PECI janë si në vijim:

- procedura të përshpejtuara të planifikimit dhe dhënies së lejeve (që zgjatin 3.5 vjet),
- një autoritet i vetëm kombëtar kompetent i cili do të veprojë si një pikë shërbimi me një ndalesë (One-Stop-Shop) për procedurat e dhënies së lejes,
- më pak kosto administrative për Promovuesit e Projektit dhe autoritetet për shkak të një procedurë më të efektshme të vlerësimit mjedisor, duke respektuar kërkesat e vijuese të ligjit të EnC,
- rritje e transparencës dhe pjesëmarrje e përmirësuar të publikut,
- rritje e dukshmërisë dhe tërheqja e investitorëve si rezultat i një kornize të përmirësuar rregullatore ku kostot ndahen për ato vende që përfitojnë më shumë nga një projekt i përfunduar, dhe
- mbështetja e mundshme financiare përmes financimit nga IPA dhe NIF.

Projektet me status të Projekteve të Interesit për Komunitetin e Energjisë (PECI) dhe Projekteve të Interesit të Përbashkët (PMI) synojnë të identifikojnë dhe kuptojnë rëndësinë ndërkufitare të një projekti, dhe si të tilla këto projekte mund të jepen me përfitime speciale. Duke e pasur statusin PECI e trason rrugën edhe për financimin e mundshëm të studimeve dhe punimeve përmes granteve nga Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimin (IPA), përkatësisht nga Fondi për Nxitjen e Investimeve në Fqinjësi (NIF) i asistencës teknike dhe financiare të Bashkimit Evropian.

Grantet e investimeve mund të vihen në dispozicion vetëm në rastet e mungesës së dëshmuar të financimit që nuk mund të mbulohet përmes tarifave të rrjetit.

Me pak fjalë, përfitimet kryesore të Rregullores (Vendimi i MC 2015/09) për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë dhe Projektet me Interes të Përbashkët janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



### • 1.3 One-Stop-Shop-i, si Autoritet Kompetent në Kosovë

Rregullorja ka për qëllim të lehtësojë procesin e dhënies së lejeve për projektet PECE/PMI duke kërkuar nga Palët Kontraktuese caktimin e një Autoriteti Kompetent përgjegjës për ndërmarrjen ose koordinimin e aktiviteteve që kanë çuar në marrjen e një Vendimi Gjithëpërfshirës, si dhe duke siguruar që kjo të bëhet brenda afateve të përcaktuara në Rregullore. Transpozimi i Rregullores në lidhje me caktimin e Autoritetit Kompetent sigurohet nga Udhëzimi Administrativ. Në përputhje me rrethanat, Divizioni për Standarde dhe Rregulla Teknike, që vepron në kuadër të Departamentit të Energjisë (One-Stop-Shop), është caktuar si Autoriteti Kompetent në Kosovë që nga data 26 korrik 2017.

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ parasheh procedurën për caktimin e Autoritetit Kompetent në Kosovë nga Ministri përgjegjës për sektorin e energjisë, me mandat për të koordinuar aktivitetet e dhënies së lejeve për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë. Neni 5 i këtij Udhëzimi Administrativ përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Autoritetit Kompetent. Për më tepër, detyrat dhe përgjegjësitë e Autoritetit Kompetent përcaktohen në Vendimin e Ministrit (Ministria e Zhvillimit Ekonomik) Nr. 1502, të datës 26 korrik 2017, me të cilin Divizioni për Standarde dhe Rregulla Teknike në kuadër të Departamentit të Energjisë pranë Ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë caktohet si Autoriteti Kompetent. Sipas vendimit në fjalë, Autoriteti Kompetent i caktuar do të veprojë si një pikë shërbimi me një ndalesë (One-Stop-Shop) për projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë. One-Stop-Shop caktohet, mes

tjerash, për të koordinuar aktivitetet për dhënien e lejeve për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë.

Udhëzimi Administrativ parashikon gjithashtu dispozita për përcaktimin e masave për harmonizimin e procedurave për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë ndërmjet Ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe autoriteteve tjera përkatëse. Masat e tilla të harmonizimit kanë për qëllim harmonizimin dhe lehtësimin e procedurave të vlerësimit mjedisor.

## 1.4 Kompetencat e One-Stop-Shop-it

Detyrat dhe përgjegjësitë e One-Stop-Shop, si Autoritet Kompetent, janë elaboruar në kuadër të Udhëzimit Administrativ dhe Vendimit për caktimin e autoritetit, të nxjerrë nga Ministri përgjegjës për energjinë.

Përgjegjësitë e One-Stop-Shop, siç përshkruhet në Vendimin e Ministrit, përfshijnë:

- lehtësimin dhe bashkërendimin e procesit të dhënies së lejeve për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë;
- bashkëpunimi me autoritetet tjera kompetente të Palëve Kontraktuese Anëtare si dhe Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në përgatitjen e planeve të përbashkëta me qëllim të koordinimit të afateve;
- publikimin dhe përditësimin, kurdo që është e nevojshme, të Doracakut të Procedurave sipas nevojës në bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse që japin leje;
- miraton apo kërkon modifikime të konceptit të pjesëmarrjes së publikut, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, dorëzuar nga Promovuesi i Projektit;
- përgatitjen e një skeme të hollësishme afatesh për procesin e dhënies së lejeve, në konsultim me Promovuesin e Projektit dhe autoritetet tjera të përfshira;
- Përgatitja e raporteve për përparimin e arritur në zhvillimin e projekteve me interes të Komunitetit të Energjisë dhe, sipas nevojës, dorëzimin e raporteve të tilla pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë; dhe,
- Çështje të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

## II. Sfondi i procesit të dhënies së lejeve

### 2.1 Skema bashkëpunuese

Kosova ka zgjedhur “skemën bashkëpunuese” e cila çon në Vendimin Gjithëpërfshirës si mekanizëm për zbatimin e procesit të dhënies së lejes.

Bazuar në opsionin e zgjedhur (d.m.th. skema bashkëpunuese), Autoriteti Kompetent është përgjegjës për:

- lehtësimin dhe bashkërendimin e procesit të dhënies së lejeve për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë. Në konsultim me autoritetet tjera të përfshira, (...) autoriteti kompetent vendos afatet kohore të arsyeshme për secilin rast, brenda të cilit

duhen nxjerr vendimet individuale. One-Stop-Shop monitoron edhe respektimin e afateve kohore nga autoritetet në fjalë. Nëse një vendim i caktuar nga një autoritet në fjalë nuk pritet të nxirret brenda afatit kohor të dhënë, ai autoritet informon autoritetin kompetent pa vonesë, duke dhënë edhe arsyetimin për atë vonesë;

- bashkërendimin deri në nxjerrjen e vendimit gjithëpërfshirës;
- publikimin dhe përditësimin, kurdo që është e nevojshme, të Doracakut të Procedurave sipas nevojës në bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse që japin leje;
- miraton apo kërkon modifikime të konceptit të pjesëmarrjes së publikut, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, dorëzuar nga Promovuesi i Projektit, brenda tre (3) muajsh nga dorëzimi i tij;
- përgatitjen e një skeme të hollësishme afatesh për procesin e dhënies së lejeve, në konsultim me Promovuesin e Projektit dhe autoritetet tjera të përfshira;
- bashkëpunimi me autoritetet tjera kompetente të Palëve Kontraktuese Anëtare si dhe Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në përgatitjen e planeve të përbashkëta me qëllim të koordinimit të afateve;
- dorëzimin e Raportit Vjetor tek Grupi përkatës mbi progresin apo vonesat në zbatim të projektit në kuptimin e proceseve të dhënies së lejeve.

One-Stop-Shop, si Autoritet Kompetent, koordinon procesin që çon në nxjerrjen e Vendimit Gjithëpërfshirës. Vendimi Gjithëpërfshirës nënkupton një tërësi vendimesh individuale, të nevojshme për t'u marrë nga Promovuesi i Projektit. Këto vendime individuale, bazuar në kompetencat e parashikuara me ligje të ndryshme, nxirren nga autoritetet përkatëse.

Autoriteti Kompetent, Në konsultim me autoritetet tjera të përfshira, si dhe pa paragjykuar afatet kohore të përcaktuara, vendos afatet kohore të arsyeshme për secilin rast, brenda të cilit duhen nxjerr vendimet individuale. Për më tepër, ai monitoron edhe respektimin e afateve kohore nga autoritetet në fjalë.

## 2.2 Roli i One-Stop-Shop-it

Roli i One-stop-shop, si Autoriteti Kompetent, në procesin e dhënies së lejes për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë dhe Projektet me Interes të Përbashkët, është të koordinojë procesin e dhënies së të gjitha pëlqimeve dhe vendimeve të ndërlidhura, të kërkuara nga të gjitha autoritetet përkatëse dhe të monitorojë respektimin e afateve kohore nga autoritetet përkatëse në përputhje me skemën bashkëpunuese. Për më tepër, siç theksohet në Nenin 5.6 të Rregullores dhe [Nenin 14<sup>1</sup>](#) të Udhëzimit Administrativ, One-Stop-Shop është përgjegjës për raportimin, mbi baza vjetore, për përparimin dhe, kur është e nevojshme, për vonesat në zbatimin e Projekteve më Interes për Komunitetin e Energjisë dhe Projekteve me Interes të Përbashkët të vendosura në territorin e Kosovës në lidhje me proceset e dhënies së lejes, dhe mbi arsyet e vonesave, nëse dhe kur ndodhin vonesa të tilla.

Roli i One-Stop-Shop për planifikimin /[lejen](#) statutore gjatë përcaktimit të ndonjë kërkesë të paraqitur me të vazhdon të mbetet një nga vlerësuesit e pavarur gjatë gjithë procesit. Detyrat e tij sipas Rregullores dhe sipas Udhëzimit Administrativ nuk do të ndikojnë në vlerësimin e tij të

---

<sup>1</sup> Teksti i paraqitur [në të kaltër](#) korrespondon si referencë ndaj dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, ndërsa referenca në Rregulloren Nr. 347/2013 është e paraqitur me ngjyrën e zezë.



paanshëm të aplikacioneve të planifikimit dhe as nuk ndërhyjnë në kompetencat e institucioneve të tjera siç përcaktohet me ligjin përkatës.

## 2.3 Roli i autoriteteve për lëshimin e lejeve

Skema Bashkëpunuese, e transpozuar sipas [Neni 5.1, paragrafi 1.1](#), parasheh që nëse një autoritet individual pritet të mos e nxjerr një vendim për pëlqim brenda afatit të caktuar, i njëjti autoritet duhet të njoftojë menjëherë One-Stop-Shop, si Autoriteti Kompetent, dhe ky njoftim duhet të përfshijë arsyetimin për vonesën. Një rol i tillë i monitorimit të One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) përfshinë vetëm elementin e afatit kohor dhe funksionin e koordinimit dhe duhet të shihet në kontekstin e skemës së hollësishme të afatit kohor për projektin individual që do të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera dhe Promovuesin e Projektit.

Roli i autoriteteve për lëshimin e lejeve mbetet i njëjtë siç përcaktohet tashmë me legjislacionin primar dhe sekondar. Ky Doracak Procedural nuk ndërhyjnë në asnjë kompetencë të ndonjë autoriteti.

## 2.4 Detyrimet dhe kërkesat

Rregullorja dhe Udhëzimi Administrativ 01/2017 vendosin detyrime dhe kërkesa lidhur me Autoritetin Kompetent (One-Stop-Shop), mbi autoritetet për lëshim të lejeve të përfshira në proces, si dhe për Promovuesit e Projektit. Një numër i detyrimeve dhe kërkesave të tilla janë renditur më poshtë:

### Pika e shërbimeve me një ndalesë (One-Stop-Shop) si Autoritet Kompetent

- Përcakton, për secilin rast, skemën e hollësishme të afateve kohore për procesin e dhënies së lejes. Kjo bëhet në konsultim me Promovuesin e Projektit dhe autoritetet e tjera. [Neni 10.4 (b) – [Neni 5.1 – 1.1](#)].
- Monitoron respektimin e afateve kohore. [Neni 8.3 (c) - [Neni 5.1 – 1.1](#)].
- Rivendos afatet kohore individuale, nëse afatet kohore origjinale nuk janë përmbushur. [Neni 8.3- [Neni 5.1 – 1.1](#)].
- Miraton apo kërkon modifikime të konceptit të pjesëmarrjes së publikut të paraqitur nga Promovuesi i Projektit. [Neni 9.3 - [Neni 5.1 – 1.4](#)].
- Dorëzon një raport vjetor tek Grupi përkatës mbi progresin apo vonesat në zbatimin e PECE / PMI në lidhje me proceset e dhënies së lejeve. [Neni 5.6 - [Neni 5.1 – 1.7](#)].
- Ndërlidhet ngushtë me Autoritetet Kompetente tek Palët e tjera Kontraktuese ose Shtetet Anëtare, dhe përgatit skema të përbashkëta që përpiqen të përafrojnë afatet kohore. [Neni 10.4(b) - [Neni 5.1 – 1.6](#)].
- Përditëson Doracakun e Procedurave sipas nevojës. [Neni 9.1 - [Neni 5.1 – 1.3](#)].

### Autoritetet për dhënien e lejeve

- Bashkëpunon me pikën e shërbimeve me një ndalesë (Autoriteti Kompetent) në realizimin e një vlerësimi të përshkrimit të hollësishëm të projektit të paraqitur nga Promovuesi i Projektit me qëllim të pranimit të njoftimit dhe përcaktimit të fillimit të procesit të dhënies së lejeve. [Neni 10.1(a) – [Neni 10.1 – 1.1](#)].
- Bashkëpunon me pikën e shërbimeve me një ndalesë (Autoriteti Kompetent) në përcaktimin e afateve kohore për vendimet e tyre. [Neni 10.4(b) – [Neni 5.1 – 1.1](#)].

- Informon pikën e shërbimeve me një ndalesë (Autoriteti Kompetent) nëse një vendim nuk pritët të përmbushet dhe të sigurojë një arsyetim për vonesën. [Neni 8.3(c) – Neni 5.1 – 1.1].
- Informon dhe kopjon vendimin e tij tek pikën e shërbimeve me një ndalesë (Autoriteti Kompetent) në të njëjtën kohë kur njofton Promovuesin e Projektit për vendimin. [Neni 8.3(c) - Neni 5.1 – 1.1].

### Promovuesit e Projektit

- Zhvillojnë planet e zbatimit për Projektin. [Neni 5.1 - Neni 8.1].
- Ofron një përshkrim të hollësishëm të projektit kur fillohet procesi Peci/PMI. [Neni 10.1(a) – Neni 10.1 – 1.1].
- Merr parasysh parimet që mbështesin pjesëmarrjen e publikut në proces. [Shtojca VI(3) – Shtojca 2].
- Zhvillon dhe dorëzon një koncept për pjesëmarrjen e publikut tek pika e shërbimeve me një ndalesë (Autoriteti Kompetent). [Neni 9.3 – Neni 9.2].
- Përgatit një raport që përmbledh rezultatet e aktiviteteve në lidhje me pjesëmarrjen e publikut para se të dorëzojë dosjen e aplikimit, duke përfshirë aktivitetet që janë mbajtur para fillimit të procesit të dhënies së lejeve [Neni 9 (4) – Neni 9.6]
- Siguron plotësinë dhe cilësinë e duhur të dosjes së aplikimit. [Neni 10.5].
- Siguron që të gjitha informacionet e kërkuara t'i vihen në dispozicion menjëherë autoriteteve përkatëse për të siguruar përmbushjen e afateve të përcaktuara kohore. [Neni 10.5 - Neni 10.8????].
- Krijon, mirëmban dhe përditëson faqen e internetit të projektit. [Neni 9.7 – Neni 9.7].
- Përgatit ndonjë raport mjedisor që do të përgatitet nga Promovuesi i Projektit gjatë fazës para aplikimit. [Neni 10.1 (a) – Neni 10.1 – 1.1].
- Bashkëpunon plotësisht me pikën e shërbimeve me një ndalesë (Autoriteti Kompetent) për të respektuar afatet kohore dhe të respektojë skemën e hollësishme të afateve kohore për procesin e dhënies së lejeve. [Neni 10.5].
- Dorëzon tek pika e shërbimeve me një ndalesë (Autoriteti Kompetent) një raport vjetor për projektin. [Neni 5.4 – Neni 8.3].

### III. DORACAKU I PROCEDURAVE

Ky Doracak i Procedurave është i destinuar për të shërbyer si instrument udhëzues që do të përdoret kryesisht nga Promovuesit e Projektit dhe pika e shërbimeve me një ndalesë (One-Stop-Shop). Prandaj, ky Doracak i Procedurave shpaloset publikisht në faqen e internetit të Ministrisë përgjegjëse për energjinë, duke siguruar kështu transparencë në secilën fazë të implementimit të Projektit me Interesit për Komunitetin e Energjisë. Autoriteti Kompetent është autoriteti përgjegjës për publikimin dhe përditësimin e Doracakut të Procedurave kur është e nevojshme.

Si përmbledhje, ky Doracak i Procedurave duhet të përdoret si një instrument kornizë për planifikim gjatë implementimit të ndonjë Projekti me Interes për Komunitetin e Energjisë dhe për këtë arsye përditësohet kur është e nevojshme.

Ky Doracak i Procedurave për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë në Kosovë nuk është dokument ligjor i detyrueshëm.

Neni 9 i Rregullores, i cili trajton çështjet e transparencës dhe pjesëmarrjes publike, parashikon që secila Palë Kontraktuese ose Autoriteti Kompetent, kur është e përshtatshme, dhe në bashkëpunim me autoritetet e tjera të interesuara, të publikojë një Doracak të Procedurave për procesin e dhënies së lejeve, të zbatueshëm për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë. Në këtë kontekst, Kosova, përmes Udhëzimit Administrativ në [Nenin 9](#) të tij, ka caktuar datën 31 Dhjetor 2017 si datë e publikimit të Doracakut të Procedurave për procesin e dhënies së lejeve që zbatohet për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë.

Doracaku i Procedurave përfshin informacionet e specifikuar në Shtojcën VI.I të Rregullores dhe [paragrafin 1 të Shtojcës 2](#) të Udhëzimit Administrativ. Për lehtësim të referimit, Shtojca VI(1) është përfshirë më poshtë:

#### Shtojca VI (1) – Paragrafi 1 i Shtojcës 2

- Doracaku i procedurave i përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 9 të këtij Udhëzimi Administrativ duhet të specifikojë së paku:
  - a) Ligjin relevant tek i cili bazohen vendimet dhe mendimet për llojet e ndryshme të projekteve relevante me interes për Komunitetin e Energjisë, duke përfshirë ato mjedisore;
  - b) Vendimet dhe mendimet relevante që duhen marrë;
  - c) Emrat dhe hollësitë kontaktuese të Autoritetit Kompetent, autoriteteve tjera dhe palëve kryesore me interes të përfshirë;
  - d) Rrjedhën e punës, që sqaron secilën fazë të procesit, duke përfshirë një kornizë kohore indikative dhe një pasqyrë koncize të procesit të vendim -marrjes;
  - e) Informatat për fushëveprimin, strukturën dhe nivelin e hollësive të dokumenteve që duhen dorëzuar me aplikacionin për vendime, duke përfshirë listën kontrolluese;
  - f) Fazat dhe mënyrat në të cilat publiku i gjerë mund të marrë pjesë në proces.

Promovuesi i Projektit mban të paktën një konsultim publik përpara se të dorëzojë dosjen e aplikimit të kompletuar pranë pikës së shërbimeve me një ndalesë (One-Stop-Shop), gjatë së cilës Promovuesi i Projektit informon palët e interesuara lidhur me projektin. Meqenëse në këtë

fazë projekti nuk është i avancuar, Promovuesi i Projektit përdor këtë proces të konsultimit publik duke marrë parasysh shqetësimet e palëve të interesuara. Promovuesi i Projektit informon dhe konsulton gjerësisht autoritetet përkatëse kombëtare dhe lokale, pronarët e tokave dhe qytetarët që jetojnë në afërsi të projektit, publikun e gjerë dhe shoqatat e tyre, organizatat ose grupet. Pika e shërbimeve me një ndalesë (One-Stop-Shop), nëse është relevante, mbështet në mënyrë aktive aktivitetet e ndërmarra nga Promovuesi i Projektit. Ky konsultim publik, për shkak të mirëmbajtjes së tij të hershme, i shërben Promovuesit të Projektit për të gjetur lokacionin ose vijën rrugore më të përshtatshme, sepse po mbahet në një fazë të hershme të procesit. Kërkesat minimale për këtë konsultim publik përfshijnë:

- a) publikimin e një broshure informuese që ka jo më shumë se 15 faqe, e cila ofron, në mënyrë të qartë dhe koncize, një pasqyrë të qëllimit dhe afateve preliminare kohore të projektit, planin shtetëror të zhvillimit të rjetit, rrugët alternative të marra parasysh, ndikimet e pritura, duke përfshirë ato të natyrës ndërkufitare, si dhe masat e mundshme zbutëse, të cilat duhen publikuar para fillimit të konsultimit, broshura informuese për më tepër duhet të paraqesë adresat e internetit të platformës së transparencës dhe të doracakut të procedurave të miratuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë;
- b) Informimin e të gjitha palëve relevante të prekura nga projekti;
- c) Ftesat me shkrim për palët e interesuara për takimet e dedikuara.

Promovuesi i Projektit përgatit një raport që përmbledh rezultatin e aktiviteteve në lidhje me konsultimet publike të mbajtura para datës së aplikimit. Ky raport dorëzohet në pikën e shërbimeve me një ndalesë (One-Stop-Shop) në kohën kur dorëzohet dosja e aplikimit për projektin.

Promovuesi i Projektit harton dhe i dorëzon Autoritetit Kompetent një koncept për pjesëmarrjen publike, brenda një periudhe indikative prej tre (3) muajsh nga fillimi i procesit për dhënien e lejeve. Promovuesi i Projektit inkurajohet të informojë për çdo formë të pjesëmarrjes publike dhe konsultimit publik të përdorur para zhvillimit të procesit të dhënies së lejeve që do të merret parasysh nga One-Stop-Shop, për derisa t'i ketë përmbyshur kërkesat për pjesëmarrjen e publikut dhe kërkesat për transparencë. Promovuesi i Projektit është përgjegjës për të siguruar informata mbi detajet e pjesëmarrjes së mëparshme publike. Koncepti për pjesëmarrjen publike mund të modifikohet gjatë fazës së zbatimit nëse, pas paraqitjes së konceptit për pjesëmarrje publike, Promovuesi i Projektit konsideron se koncepti ka nevojë për ndryshime të konsiderueshme. Ndryshimet e tilla ndahen me One-Stop-Shop në mënyrë që të lejohen modifikimet. Është nën diskrecion të vetëm One-Stop-Shop për të konkluduar nëse janë të rëndësishme apo jo ndryshimet në konceptin për pjesëmarrje publike. One-Stop-Shop vlerëson modifikimet e propozuara, kupton arsyetimin për modifikim dhe konsulton individualisht institucionet përkatëse.

Promovuesi i Projektit krijon dhe rregullisht mirëmban një faqe të internetit me informacione që kanë të bëjnë me projektin përkatës me interes për Komunitetin e Energjisë. Kjo faqe e internetit është e lidhur njëkohësisht me faqen e internetit të Komunitetit të Energjisë. Kjo faqe e internetit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- a) të ketë broshurë informuese;

- b) të ketë një përmbledhje jo-teknike dhe rregullisht të përditësuar që ka jo më shumë se 50 faqe dhe që pasqyron gjendjen e tanishme të projektit dhe që, në rast të përditësimeve, paraqet qartë ndryshimet në versionet e mëparshme;
- c) të ketë planifikimin e projektit dhe të konsultimeve publike, ku tregohen qartë datat dhe vendndodhjet për konsultime publike, datat dhe vendndodhjet për dëgjimet publike si dhe temat e parashikuara përkatëse për këto dëgjime publike;
- d) të ketë informatat kontaktuese me qëllim të marrjes së dokumentacionit të plotë të aplikimit;
- e) të ketë informatat kontaktuese me qëllim të parashtrimit të komenteve dhe kundërshtimeve gjatë konsultimeve publike.

Promovuesi i Projektit publikon informacionet relevante në mjetet përkatëse të informimit, në të cilat publiku ka qasje të lirë, siç janë TV, Radio, gazeta, etj.

## IV. Procesi i dhënies së lejeve

Procesi i dhënies së lejeve përbëhet nga dy procedura: (a) procedura para aplikimit dhe (b) procedurën statutore/[ligjore](#) e dhënies së lejeve.

### 4.1 Faza e njoftimit

Me qëllim të përcaktimit të fillimit të procesit të dhënies së lejeve, Promovuesi i Projektit duhet të njoftojë paraprakisht One-Stop-Shop (Autoritetin Kompetent). Gjatë periudhës 3 mujore në dispozicion për të pranuar ose refuzuar njoftimin, One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) do të kontaktojë të gjitha autoritetet përkatëse për marrë vlerësimin e tyre nëse projekti ka arritur ose jo pjekurinë e mjaftueshme për të filluar me procesin e dhënies së lejeve. Prandaj, është rëndësishme thelbësore që Promovuesi i Projektit të sigurojë hollësi rreth pëlqimeve që do të kërkohen në këtë fazë. Në rast se nuk identifikohet ndonjë pëlqim i kërkuar, atëherë si pasojë mund të ketë vonesa në projekt.

Pas njoftimit të projektit nga Promovuesit e Projektit, One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) ka 3 muaj në dispozicion për të pranuar ose refuzuar njoftimin (në emër të autoriteteve përkatëse). Si pjesë e njoftimit për fillimin e procesit të dhënies së lejes, kërkohet nga Promovuesi i Projektit që t'i paraqesë One-Stop-Shop (Autoritetit Kompetent) një përshkrim arsyeshëm të detajuar të projektit. Si pjesë e përshkrimit të detajuar të projektit, One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) do të pret që Promovuesi i Projektit të paraqesë në detaje shtrirjen e projektit dhe të listojë të gjitha pëlqimet të cilat, sipas mendimit të Promovuesit të Projektit, kërkohen. Procedura para aplikimit fillon kur One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) të pranojë njoftimin e paraqitur nga Promovuesi i Projektit sipas Nenit 10.1 (a) të Rregullores dhe [Nenit 10.1 \(1.1\)](#) të Udhëzimit Administrativ.

**Diagrami 1: Faza e njoftimit për fillimin e procesit për dhënie të lejeve:**



## 4.2 Procedura para aplikimit

Procedura para aplikimit mbulon periudhën ndërmjet fillimit të procesit për dhënien e lejeve dhe pranimit nga One-Stop-Shop (Autoritetit Kompetent) të dosjes së dorëzuar të aplikimit. Kjo periudhë do të zhvillohet brenda një periudhe indikative prej 2 vitesh. Neni 10.2 i Rregullores dhe [Neni 10.2](#) i Udhëzimit Administrativ parashikojnë një zgjatje të periudhës kohore maksimalisht për 9 muaj (për të dy procedurat së bashku).

Të gjitha raportet e tjera, duke përfshirë raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor dhe pëlqimeve dhe lejeve tjera, të cilat duhet të përgatiten nga Promovuesi i Projektit, duhet të përgatiten në fazën para aplikimit, pasi të pranohet One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) njoftimin për fillimin e procesit të dhënies së lejeve, sipas Neni 10.1(a) të Rregullores dhe [Neni 10.1\(1.1\)](#) të Udhëzimit Administrativ.

One-Stop-Shop, si Autoritet Kompetent do të zhvillojë një program të hollësishëm për procesin e dhënies së lejeve. Ky program do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Promovuesin e Projektit dhe autoritetet tjera përkatëse. Duhet të theksohet se ky program duhet të përfshijë çdo proces te ankesave administrative, të përfshirë në procedurat e ndryshme të autoritetit për dhënie të pëlqimit, që mund të zbatohen për projektin. Me qëllim të udhëzimit të qartë gjatë përgatitjes së programit të detajuar për procesin e dhënies së lejeve, Autoriteti Kompetent shfrytëzon 30 ditë për çdo ankesë administrative pranë ndonjë autoriteti administrativ. Kjo mund të përfshijë çdo ankesë administrative kundër një vendimi të marrë nga ndonjë autoritet administrativ i mandatar për çfarëdo procedure të dhënies së pëlqimit. Megjithatë, nuk do të përfshijë kundërshtimet ligjore para gjykatave. Shtojca VI(2) e Rregullores dhe [Shtojca 2, paragrafi 2](#) i Udhëzimit Administrativ përcaktojnë udhëzimet për një program të tillë. Udhëzimet të cilat janë si kërkesa minimale, janë si më poshtë:

- a) vendimet dhe mendimet relevante që duhen marrë;
- b) autoritetet, palët e interesit, si dhe publikun që me gjasë do të ndikohen;
- c) fazat individuale të procedurës dhe kohëzgjatjen e tyre;
- d) caqet kryesore që duhen arritur si dhe afatet e tyre në lidhje me vendimin gjithëpërfshirës që duhet marrë;
- e) burimet e planifikuara nga autoritetet dhe nevojat e mundshme për burime shtesë.

Kjo fazë e procesit përfshin edhe konsultimin publik dhe pjesëmarrjen publike, që duhet të realizohen nga Promovuesi i Projektit (dhe palët përkatëse, nëse është e përshtatshme), të cilat janë të detajuara më tej në Seksionin 0. Promovuesi i Projektit ka një periudhë indikative prej 3 muajsh, nga fillimi i procesit të dhënies së lejeve, për t'i dorëzuar One-Stop-Shop (Autoritetit Kompetent) një koncept të pjesëmarrjes publike. One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) duhet ose të modifikojë ose të miratojë konceptin brenda 3 muajve, pas konsultimit me autoritetet e tjera përkatëse, siç konsiderohet e përshtatshme. Detajet janë dhënë në Seksionin 0.

Para dorëzimit të aplikacionit të plotë në One-Stop-Shop, Promovuesi i Projektit mban të paktën një konsultim publik, ndërsa detaje të mëtejme janë dhënë në Seksionin 0. Gjatë konsultimit publik, në një fazë të hershme dhe para dorëzimit të propozimit, Promovuesi i Projektit informon palët e interesuara në lidhje me projektin. Nëse është e rëndësishme, One-Stop-Shop

mbështet aktivitetet e ndërmarra nga Promovuesi i Projektit në mënyrë aktive. Kërkesat minimale për këtë konsultim publik përfshijnë:


- a) publikimin e një broshure informuese që ka jo më shumë se 15 faqe, e cila ofron, në mënyrë të qartë dhe koncize, një pasqyrë të qëllimit dhe afateve preliminare kohore të projektit, planin shtetëror të zhvillimit të rjetit, rrugët alternative të marra parasysh, ndikimet e pritura, duke përfshirë ato të natyrës ndërkufitare, si dhe masat e mundshme zbutëse, të cilat duhen publikuar para fillimit të konsultimit, broshura informuese për më tepër duhet të paraqesë adresat e internetit të platformës së transparencës dhe të doracakut të procedurave të miratuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë;
- b) informimin e të gjitha palëve të prekura nga projekti përmes faqes së internetit të referuar në nenin 9(7) të Rregullores nr. 347/2013 dhe [Nenit 9.7](#) të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 dhe përmes mënyrave tjera të përshtatshme të informimit;
- c) ftesë me shkrim për palët relevante të prekura, në takime të dedikuara, gjatë të cilave diskutohen brengat e mundshme.

Promovuesi i Projektit përgatit një raport që përmbledh rezultatin e aktiviteteve që lidhen me pjesëmarrjen publike, të realizuara para aplikimit. Ky raport dorëzohet në One Stop Shop në kohën kur dorëzohet dosja e aplikacionit të projektit.

Promovuesit e projektit duhet ta kenë parasysh se neni 9(3) i Rregullores dhe [neni 9.5](#) i Udhëzimit Administrativ parashikon që One Stop Shop (Autoriteti Kompetent) duhet të marrë parasysh çdo formë të pjesëmarrjes dhe konsultimit publik që është zhvilluar para fillimit të procesit për dhënie të lejes gjatë konsiderimit të konceptit të pjesëmarrjes publike.

Promovuesit e Projektit mirëmbajnë një faqe interneti funksionale, duke publikuar informatat përkatëse për publikun. Detajet jepen në seksionin 0.


Është bashkëngjitur diagrami i rrjedhjes së procedurës para aplikimit:





## Procesi i dhënies së lejeve për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë/Projektet me Interes të Përbashkët: Një pasqyrë e procedurës së para-aplikimit

Diagrami 2: Procedura e para-aplikimit:



### 4.3 Procedura statutore/ligjore për dhënien e lejeve

Procedura statutore/[ligjore](#) për dhënien e lejeve mbulon periudhën nga data e pranimit të dosjes së aplikimit të dorëzuar, deri në datën e nxjerrjes së vendimit gjithëpërfshirës. Neni 10.1(b) i Rregullores dhe [Neni 10.1 \(1.2\)](#) i Udhëzimit Administrativ parashikojnë që periudha të mos jetë më e gjatë se një vit e gjashtë muaj. Kohëzgjatja e kombinuar e të dy procedurave nuk duhet të tejkalojë periudhën prej 3 vjet e 6 muaj, Neni 10.2 i Rregullores dhe [Neni 10.2](#) i Udhëzimit Administrativ parashikojnë që nëse One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) konsideron që ndonjëra apo të dy procedurat (procedura para aplikimit dhe procedura statutore/[ligjore](#) për dhënie të lejeve) nuk do të përmbillen brenda afateve kohore të përcaktuara, ai mund të vendosë, para skadimit të afateve si dhe për rastet individuale, të zgjasë njërin apo të dy afatet me maksimalisht 9 muaj për të dy procedurat e kombinuara.

Nëse ndonjë autoritet tjetër përgjegjës për dhënien e një pëlqimi, një leje ose ndonjë akti tjetër që kërkohet si pjesë e vendimit gjithëpërfshirës, refuzon miratimin për pëlqim ose kur One-Stop-Shop vendos të refuzojë lejimin/miratimin e planifikimit, atëherë kjo do të rezultojë në mos nxjerrjen e vendimit gjithëpërfshirës.


Gjatë vlerësimit të çdo aplikimi të bërë, One-Stop-Shop (dhe, kur është e nevojshme, autoritetet tjera gjatë vlerësimit të aplikimeve të bëra tek ta) do t'i kushtoj vëmendje të plotë planifikimit, aspekteve mjedisore, shëndetit të njeriut si dhe çështjeve dhe obligimeve tjera përkatëse që normalisht do të ishin pjesë e përgjegjësisë së tyre statutore dhe pjesë e vlerësimit të projekteve. Kjo do të përfshijë ato që rrjedhin nga dispozitat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Habitatet (dhe Zogjtë), nga Direktivat kornizë për ujëra dhe nga Konventa e Aarhus-it. Gjithashtu, One-Stop-Shop do të ketë parasysh dispozitat e Nenit 8(5) dhe 10(4) të Rregullores, përkatësisht [Nenit 5.1\(1.6\)](#) dhe [Nenit 10 \(Shtojca 2: paragrafi 1.5\)](#) dhe, kur është e mundur, do të përpiqet të sigurojë procedura të përbashkëta me Shtetet tjera Anëtare në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Promovuesit e Projektit i kushtojnë vëmendje Dokumentit Udhëzues “Thjeshtëzimi i procedurave mjedisore për projektet e infrastrukturës së energjisë me interes të përbashkët (PCI-të)”, i publikuar nga Komisioni Evropian, Mjedisi dhe Energjia, në korrik të vitit 2013. Ky dokument është në dispozicion [këtu](#).

Gjatë kësaj periudhe, roli i One-Stop-Shop kryesisht përqendrohet në monitorimin e afateve kohore të secilit pëlqim/leje, duke u bazuar në programin e hollësishëm për dhënien e lejeve. One-Stop-Shop si Autoritet Kompetent do të kontaktojë rregullisht autoritetet përkatëse për të kërkuar përditësime mbi progresin e bërë dhe për të vendosur nëse ka gjasa të arrihen afatet e fundit. Për të lehtësuar këtë proces, Promovuesve të Projektit u kërkohet të mbajnë të informuar Autoritetin Kompetent për çdo ndryshim apo vonesë në projekt, në mënyrë që monitorimi të jetë efektiv.

Pjesëmarrja publike në kuadër të proceseve individuale të dhënies së lejeve të operuara nga autoritetet tjera në Kosovë, mbetet nën kompetencën e këtyre autoriteteve në këtë fazë statutore/[ligjore](#) për dhënien e lejeve. Kur paraqitet një projekt para One-Stop-Shop si aplikacion për planifikim, One-Stop-Shop do të ndjek procedurën e vetë për pjesëmarrje publike.


Me poshtë është bashkëngjitur diagrami i rrjedhjes së procedurës statutore/**ligjore** për dhënien e lejeve:



## Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë/Projektet me Interes të Përbashkët

### Procesi i dhënies së lejeve. Përmbledhje e procedurës statutore/ligjore për dhënien e lejeve

Diagrami 3: Procedura statutore/ligjore e dhënies së lejeve:



#### 4.4 Lista e dokumenteve relevante:

Dokumentet vijuese publike janë relevante për ta kuptuar procesin e Zhvillimit Strategjik të Infrastrukturës dhe për ta kuptuar pjesëmarrjen e publikut në atë proces. Ne vërejmë që secila leje/pëlqim që duhet të merret nga autoritetet publike relevante kalon përmes një procesi të pjesëmarrjes së publikut.

Dokumentet kryesore relevante për të kuptuar më mirë procesin e pjesëmarrjes së publikut janë renditur si më poshtë:

- Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës, [2017-2026](#);
- Plani Hapësinor i Kosovës, [2010-2020+](#);
- Udhëzimi Administrativ ([MMPH – UA nr. 16/2015](#)) për Informim, Pjesëmarrje të Publikut dhe Palëve të Interesuara në Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

#### 4.5 Marrja e vendimit gjithëpërfshirës

Sipas Skemës Bashkëpunuese, marrja e një vendimi gjithëpërfshirës koordinohet nga One-Stop-Shop, duke u bazuar në vendimet individuale, ligjërish të detyrueshme të autoriteteve përkatëse.

Vendimi gjithëpërfshirës, i cili përfaqëson një tërësi vendimesh, duke mos përfshirë gjykatat ose tribunalet, përcakton nëse Promovuesit të Projektit duhet t'i jepet ose jo autorizimi për ndërtimin e infrastrukturës energjetike për realizimin e projektit.

Pas dhënies së autorizimit final nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë sipas kushteve të përcaktuara të procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja, përderisa autorizimi i tillë final është vendimi i fundit që duhet të merret nga Promovuesi i Projektit në atë kohë, konsiderohet që Vendimi Gjithëpërfshirës është marrë. Sipas asaj që u tha më lart, Vendimi Gjithëpërfshirës nënkupton dhënien e të gjitha granteve/aprovimeve/lejeve, siç janë listuar në planin e hollësishëm të procesit të dhënies së lejeve, ndërsa vendimi i fundit (autorizimi final për ndërtim) jepet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Në rrethana të tilla, Vendimi Gjithëpërfshirës nuk do ta marrë formën e një dokumenti të veçantë të lëshuar nga One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent).

## V. PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Pjesëmarrja e publikut si instrument i transparencës përdoret në të gjitha fazat e zbatimit të këtij Doracak u të Procedurave. Ky kapitull shpjegon procesin e praktikuar në faza të ndryshme të pjesëmarrjes së publikut, për informimin e palëve të prekura te interesit gjatë zbatimit të Projekteve me Interes për Komunitetin e Energjisë.

### 5.1 Neni 9 i Rregullores nr. 347/2013 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017

Neni 9 i Rregullores dhe [Neni 9.1](#) i Udhëzimit Administrativ sigurojnë që të gjitha palët e përfshira në procesin e dhënies së lejeve duhet të ndjekin parimet për pjesëmarrjen e publikut të përcaktuara në Shtojcën V1.3, përkatësisht ato të [Shtojcës 2 paragrafi 3](#) të Udhëzimit Administrativ.

Këto parime janë renditur si në vijim:

- a) Palët me interes të prekura nga një Projekt me Interesit për Komunitetin e Energjisë/Projekt me Interesit të Përbashkët, duke përfshirë autoritetet relevante shtetërore, rajonale dhe lokale, pronarët e tokave dhe qytetarët që jetojnë në afërsi me projektin, publikun e gjerë dhe shoqatat, organizatat dhe grupet e tilla, duhen informuar e konsultuar gjerësisht në fazë të hershme, kur brengat e mundshme të publikut ende mund te merren parasysh, si dhe në mënyrë të hapur e transparente. Aty ku vlen, Autoriteti Kompetent në mënyrë aktive përkrah aktivitetet e ndërmarra nga Promovuesi i Projektit.
- b) Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që procedurat e konsultimit publik për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë të grupohen bashkë kurdo që është e mundur. Secili konsultim publik duhet të mbulojë të gjitha lëndët relevante për fazën e caktuar të procedurës, ndërsa një lëndë relevante për fazën e caktuar të procedurës nuk duhet adresuar në më shumë se një konsultim publik, megjithatë, një konsultim publik mund të bëhet në më shumë se një lokacion gjeografik. Lëndët e adresuara në një konsultim publik duhet të pasqyrohen qartë në njoftimin për konsultim publik.
- c) Komentet dhe kundërshtimet do të jenë të pranueshme që nga fillimi i konsultimeve publike e deri në skadimin e afatit.

One-Stop-Shop, si Autoritet Kompetent për Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë/Projektet me Interes të Përbashkët, do të operojë sipas këtyre parimeve.

### V.2 Procedura e para-aplikimit dhe pjesëmarrja e publikut

Promovuesi i Projektit ka një periudhë indikative prej 3 muajsh nga fillimi i procesit të dhënies së lejes për dorëzimin e konceptit të pjesëmarrjes së publikut në One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent). One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) duhet ose ta modifikojë ose ta miratojë konceptin brenda 3 muajve.

Modifikimi ose miratimi nga One-Stop-Shop do të bëhet pas konsultimit me autoritetet e tjera relevante, nëse kjo konsiderohet si e përshtatshme.

Për t'i dhënë efekt parimit të pjesëmarrjes së publikut, që publiku i gjerë, palët e interesuara dhe pronarët e tokave duhet të informohen gjerësisht, One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) do të kërkojë nga Promovuesit e Projektit që të informojnë dhe konsultojnë publikun e gjerë sa

më parë që është e mundur, e që mund ta përfshijë kohën para se Promovuesi i Projektit ta njoftojë formalisht One-Stop-Shop (Autoritetin Kompetent) në lidhje me projektin sipas Nenit 10(1)(a) të Rregullores dhe [Nenit 10.1 \(1.1\)](#) të Udhëzimit Administrativ. One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) tërheq vëmendjen e Promovuesve të Projektit lidhur me dispozitat e Nenit 9(3) të Rregullores dhe [Nenit 9.3](#) të Udhëzimit Administrativ i cili siguron që One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) do ta merr parasysh çdo formë të pjesëmarrjes dhe konsultimit të publikut që është zhvilluar përpara fillimit të procesit të dhënies së lejes për të arritur në cilindo pikë të vendimit në lidhje me konceptin e pjesëmarrjes së publikut.

### 5.3 Pjesëmarrja e publikut para dorëzimit të dosjes së aplikacionit

Shtojca VI(5) e Rregullores dhe [Shtojca 2 \(paragrafi 5\)](#) i Udhëzimit Administrativ përcaktojnë atë që, të paktën, palët relevante do të sigurojnë. Këto hollësi janë:

- d) Të publikojë një broshurë informuese me jo më shumë se 15 faqe, e cila ofron, në mënyrë të qartë dhe koncize, një pasqyrë të qëllimit dhe afateve preliminare kohore të projektit, planin shtetëror të zhvillimit të rrjetit, rrugët alternative të marra parasysh, ndikimet e pritura, duke përfshirë ato të natyrës ndërkufitare, si dhe masat e mundshme zbutëse, të cilat duhen publikuar para fillimit të konsultimit, broshura informuese për më tepër duhet të paraqesë adresat e internetit të platformës së transparencës dhe të doracakut të procedurave nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë;
- e) Të informojë të gjitha palët e prekura për projektin përmes faqes së internetit të përcaktuar në Nenin 9(7) të Rregullores nr. 347/2013 dhe [Nenit 9.7](#) të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 dhe mjeteve të tjera përkatëse të informimit;
- f) Të ftojë në formë të shkruar palët relevante të prekura në takime të dedikuara, gjatë të cilave mund të diskutohen brengat e mundshme.

One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent), gjatë fazës së procedurës para-aplikimit do të presë nga Promovuesi i Projektit që të sigurojë hollësitë se ka qenë në përputhje me atë që u përmend më sipër.

### 5.4 Koncepti i pjesëmarrjes së publikut

Neni 9.3 i Rregullores dhe [Neni 9.2](#) i Udhëzimit Administrativ përcaktojnë që Promovuesi i Projektit, brenda një periudhe indikative prej 3 muajsh nga fillimi i procesit të dhënies së lejes, sipas Nenit 10(1)(a) të Rregullores dhe [Nenit 10.1\(1.1\)](#) të Udhëzimit Administrativ, do ta zhvillojnë dhe dorëzojnë konceptin për pjesëmarrjen e publikut në One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent). Brenda tre muajve nga pranimi i konceptit, One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) kërkon ose modifikime ose miratimin e konceptit. One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) do të përpiqet ta merr mendimin e autoriteteve të tjera relevante lidhur me konceptin.

Shtojca VI(4) e Rregullores dhe [Shtojca 2 paragrafi 4](#) i Udhëzimit Administrativ japin hollësi për informatat minimale që duhet të përfshihen në koncept. Këto hollësi janë:

- Palët me interes që preken dhe adresohen;
- Masat e parapara, duke përfshirë lokacionet e propozuara dhe datat e takimeve të dedikuara;
- Afatet kohore;

- Resurset njerëzore që dedikohen për detyrat përkatëse.

One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) tërheq vëmendjen e Promovuesit të Projektit për kërkesat që kanë të bëjnë me privatësinë e të dhënave personale, ashtu siç përcaktohet në Ligjin nr. 03 / L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, lidhur me çfarëdo material që ka të bëjë me palët e interesuara të identifikueshme në konceptin e pjesëmarrjes së publikut.

Në përgjithësi, One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) ka për qëllim, nëse e ka miratuar konceptin e pjesëmarrjes së publikut për një projekt specifik, që t'i kërkojë Promovuesit të Projektit të publikojë konceptin e miratuar të pjesëmarrjes së publikut në faqen e internetit të projektit, si një mënyrë shtesë e rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut.

Për më tepër, One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) konsideron se të gjitha kërkesat e pranuar si pjesë e procesit të konsultimit publik duhet të publikohen në faqen e internetit të projektit, përveç nëse parashtruesi ka dhënë arsytetime të arsyeshme në mënyrë që One-Stop-Shop si Autoriteti Kompetent ta shqyrtojë atë, duke shprehur dëshirën që kërkesa e tyre të pranohet në besim. Promovuesit e Projektit duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre në bazë të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me informatat personale, siç janë adresat dhe informatat kontaktuese.

## 5.5 Faqja e internetit të projektit dhe pjesëmarrja e publikut

Shtojca VI(6) e Rregullores dhe [Shtojca 2 paragrafi 6](#) i Udhëzimit Administrativ përcaktojnë informatat minimale që faqja e internetit për projektin duhet të vërë në dispozicion më së paku këto si në vijim:

- a) broshurën informuese të përcaktuar në paragrafin 8.4(a) më lartë dhe në [paragrafin 5 të Shtojcës 2](#).
- b) një përmbledhje jo-teknike dhe rregullisht të freskuar, me jo më shumë se 50 faqe, që reflekton gjendjen aktuale të projektit, si dhe që paraqet qartë, në rast të azhurnimeve, ndryshimet në versionet e mëparshme; Promovuesit e PECl/PMI janë të lirë që t'i vënë në dispozicion informatat shtesë në faqet e tyre të internetit; megjithatë, broshurat informuese dhe dokumenteve përmbledhëse të statusit aktual duhet të jenë dokumente të veçanta, të cilat ofrojnë një pamje konkurruese dhe jo çorientuese të projektit dhe statusit të tij aktual;
- c) planifikimi i projektit dhe konsultimeve publike, që reflekton qartë datat dhe lokacionet për konsultime dhe dëgjime publike dhe lëndët e parapara relevante për ato dëgjime;
- d) informatat kontaktuese me qëllim të sigurimit të tërësisë së plotë të dokumenteve të aplikimit;
- e) informatat kontaktuese me qëllim të parashtrimit të komenteve dhe kundërshtimeve gjatë konsultimeve publike;

One-Stop-Shop” (Autoriteti Kompetent) do të presë që faqja e internetit të mirëmbahet nga Promovuesi i Projektit në fjalë dhe që të gjitha ndryshimet në përmbajtjen e faqes së internetit të jenë të dokumentuara, ashtu që One-Stop-Shop (Autoriteti Kompetent) të mund të gjurmojë se cila informatë është vënë në dispozicion për publikun e përgjithshëm në periudha të caktuara.



## 5.6 Procedura statutore/ ligjore e dhënies së lejeve dhe pjesëmarrja e publikut

Si Autoritet Kompetent në bazë të skemës bashkëpunuese, roli i One-Stop-Shop është kryesisht për të bashkërenduar marrjen e vendimit gjithëpërfshirës dhe për të siguruar që është marrë brenda periudhës së përcaktuar në Rregullore dhe në Udhëzimin Administrativ. Vendimi gjithëpërfshirës duke qenë një tërësi vendimesh që nuk përfshinë gjykatat ose tribunalet që vendosin nëse një Promovuesi të Projektit duhet t'i jepet ose jo autorizimi për ndërtimin e infrastrukturës së energjisë për realizimin e projektit.

Pjesëmarrja e publikut në kuadër të proceseve individuale të dhënies së pëlqimit, të drejtuar nga autoritetet e tjera në Kosovë, në këtë mënyrë, mbetet në kuadër të kompetencës së këtyre autoriteteve të kësaj faze statutore/[ligjore](#) të dhënies së lejeve. Përderisa një projekt i dorëzohet One-Stop-Shop si aplikacion planifikimi, One-Stop-Shop do t'i ndjekë procedurat e veta të pjesëmarrjes së publikut.

## VI. LEGJISLACIONI RELEVANT PËR DHËNIEN E LEJEVE

Një përmbledhje e legjislacionit relevant për dhënie e lejeve është dhënë më poshtë. Ky kapitull i Doracakut të Procedurave duhet të përditësohet sa herë që autoritetet përgjegjëse të miratojnë legjislacion të ri ose ta ndryshojnë atë ekzistues.

### 6.1 Planifikimi hapësinor (mjedisor, ndërtimor dhe shpronësor)

#### 6.1.1. Planifikimi hapësinor

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe palët e tjera të interesit kërkohet të hartojnë një planifikim hapësinor të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar në të tërë territorin e Kosovës, si një vlerë e përbashkët kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, përdorimit racional të hapësirës dhe duke e marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore. Në përputhje me dispozitat e ligjit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor harton Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës. Plani Hapësinor i Kosovës është një dokument multi-sektorial që identifikon në aspektin hapësinor zhvillimin e politikave sociale, ekonomike dhe hapësinore me qëllim të krijimit të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar në tërë territorin e Kosovës. Harta Zonale e Kosovës është një dokument multi-sektorial që përcakton llojin, destinacionin, përdorimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatjen dhe projektionet e investimeve publike dhe private të disponueshme për tërë territorin e Kosovës për një periudhë prej së paku tetë (8) viteve.

Harta Zonale e Kosovës përcakton sipërfaqet dhe masat (ndër të tjera) për:

- Zhvillimin ekonomik;
- Përmirësimin e infrastrukturës teknike të nivelit qendror;
- Përmirësimin e infrastrukturës publike të nivelit qendror.

Krijimi i Hartës Zonale të Kosovës bazohet në:

- Deklaratën për vizionin, parimet dhe qëllimet sektoriale të zhvillimit strategjik;
- Krijimin e kushteve më të mira të jetesës, mundësive të barabarta ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë natyrore, lokaliteteve kulturore dhe arkeologjike;

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do t'i përcaktojë elementet dhe kërkesat themelore për projektimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës.

Në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 10/2016 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës, është dhënë qëndrimi se Harta Zonale e krijuar mund të modifikohet, me qëllim të akomodimit të projekteve që do të zbatohen. Ndryshimet në hartën zonale janë bërë sipas të njëjtave procedura si për miratimin. Ndryshimet në Hartën Zonale <sup>2</sup> mund të kërkohen po ashtu nga ndonjë subjekt tjetër i cili nuk është pjesë e qeverisë qendrore ose lokale.

---

<sup>2</sup> Shënim: Kosova është në proces të zhvillimit të Hartës së saj të parë Zonale.

### 6.1.2 Leja/pëlqimi mjedisor

Se a duhet ose jo të ndiqet një procedurë e vlerësimit të ndikimit në mjedis varet nga natyra e projektit dhe cilat pasoja të mundshme e të konsiderueshme mund t'i ketë projekti për mjedisin. Kriteret për vlerësim janë dhënë në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Sipas dispozitave të Shtojcës 1 të Ligjit, hartimi i raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis është i obligueshëm. Në raste të tjera, sipas Shtojcës 2 të Ligjit, duhet të bëhet një vlerësim nëse vlerësimi i ndikimit në mjedis është i obligueshëm.

Procedura mund të përmblihet shkurtimisht si në vijim:

Nëse ka nevojë për një vlerësim të ndikimit në mjedis, e tërë procedura (duke përfshirë dëgjimin publik) zgjat rreth 60-70 ditë. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet të përgatitet nga një kompani e licencuar në Kosovë.

Pas zbatimit të suksesshëm të procesit VNM, zhvilluesi i projektit e merre pëlqimin mjedisor, i cili ka vlefshmëri prej 2 viteve. Pëlqimi mjedisor është bazë për projektin që të marrë lejen mjedisore përpara fillimit të operimit.

Vlefshmëria e pëlqimit mjedisor pezullohet nëse, brenda dy (2) viteve nga data e pranimit të Vendimit për pëlqimin mjedisor, aplikanti nuk merr leje ndërtimi ose miratim për realizimin e projektit; ose lokacioni ku do të realizohet projekti nuk është përgatitur dhe nuk është funksional.

Pasi të ekzekutohet projekti sipas parametrave të dhënë në pëlqimin mjedisor, zhvilluesi i projektit pritët të parashtrojë kërkesë për leje mjedisore, e cila lëshohet brenda një periudhe deri në maksimum 90 ditë. Leja mjedisore është e vlefshme për 5 vite dhe zhvilluesi i projektit kërkohet të parashtrojë kërkesë për zgjatjen e afatit të lejes mjedisore dy muaj para skadimit të saj.

Dokumentet /pëlqimet e kërkuara gjatë procesit të VNM-së dhe dokumentet e tjera plotësuese për marrjen e lejes mjedisore:

- Pëlqimi arkeologjik i dokumentit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, sipas Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore, ku thuhet se në skicën e projektit nuk ka ndonjë monument arkeologjik ose kulturor të identifikuar të interesit jetik (Koha e përpunimit 7-10 ditë pune).
- Pëlqimi komunal që projekti i propozuar nuk bie ndesh me planet dhe programet paraprake ashtu siç është paraqitur në planet e zhvillimit komunal. (Koha e përpunimit 7-10 ditë pune)
- Klasifikimi i tokës dhe pëlqimi në lidhje me ndryshimin në shfrytëzimin përfundimtarë, varësisht nëse është i përkohshëm ose i përhershëm, rregullohet sipas Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 41/2006.

- Ndryshimi i përhershëm i destinacionit të tokës bujqësore të klasave 1 deri 4 bëhet me vendim të Kuvendit Komunal pas marrjes së pëlqimit të Ministrisë. Procedura pritet të zgjasë 45-50 ditë pune.
- Ndryshimi i përhershëm i destinacionit të tokës bujqësore të klasave 5 deri në 6 bëhet me vendim të Kuvendit Komunal. Procedura pritet të zgjasë 10 ditë pune.
- Ndryshimi i përkohshëm i destinacionit të tokës bujqësore të klasave 1 deri në 6 bëhet me vendim të Kuvendit Komunal. Procedura pritet të zgjasë 20 ditë pune.
- Zëvendësimi i përhershëm dhe i përkohshëm i shfrytëzimit të tokës bujqësore të klasave 7 deri në 8 bëhet me pëlqim urbanistik. Ky pëlqim lëshohet nga organi i planifikimit me pëlqimin e Autoritetit të Bujqësisë. Pëlqimi i organit për bujqësi do të jepet në formën e një vendimi me shkrim i cili do ta përmbajë arsyetimin. Procedura pritet të zgjasë 35 ditë pune.

#### 6.1.3 Leja ndërtimore

Kushtet e ndërtimit dhe leja ndërtimore lëshohen në bazë të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim, bazuar në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Pëlqimin Mjedisor. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është autoriteti përgjegjës për lejimin e projekteve me rrezikshmëri të lartë të Kategorisë III, siç përcaktohet me Ligjin për Ndërtim. Aplikimet për leje ndërtimore nevojitet të përgatiten nga një projektues i licencuar në Kosovë.

Kushtet e ndërtimit përcaktohen në bazë të një kërkesë zyrtare të parashtruar nga Promovuesi i Projektit. Kushtet e tilla, të cilat janë specifike për secilin projekt, përcaktojnë kriteret e ndërtimit që Promovuesi i Projektit duhet t'i përmbushë në mënyrë që të jetë i pranueshëm për leje ndërtimore. Kushtet e ndërtimit lëshohen brenda 30 ditëve nga dita kur aplikacioni të konsiderohet si e kompletuar.

Leja ndërtimore, e cila bazohet në kushtet e ndërtimit, lëshohet brenda 45 ditëve nga dita e aplikimit dhe ka vlefshmëri prej një (1) viti për fillimin e procesit të ndërtimit. Aplikuesi mund të bëjë kërkesë për ta vazhduar vlefshmërinë e kësaj leje edhe për një (1) vit.

#### 6.1.4. Shpronësimi i pronës së paluajtshme

Shpronësimi i pronës së paluajtshme ndodhë duke u bazuar në kërkesat e ndërtuesit privat për interes publik legjitim. Ligji nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme (dhe ndryshimin e ligjit) përcakton procedurën dhe afatet kohore të shpronësimit ose të drejtave të servitutit për çdo qëllim publik legjitim në lidhje me aktivitetet për gjenerimin, furnizimin, transmetimin ose shpërndarjen e energjisë. Ministria e Financave do ta përcaktojë një vlerë të drejtë kompensimi për pronën e paluajtshme që i nënshtrohen procedurës së shpronësimit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në emër të Qeverisë, vepron si autoritet shpronësues. Sipas ligjit, kur Promovuesi i Projektit aplikon për shpronësim, ai duhet t'i paraqesë dokumentet në lidhje me lokacionin dhe numrin e secilës ngastër në fjalë të pronës së paluajtshme, si dhe një përshkrim të hollësishëm të qëllimit publik për të cilin kërkohet

shpronësimi. Promovuesi i Projektit duhet të argumentojë që realizimi i projektit mund të arrihet vetëm përmes shpronësimit dhe zgjedhja për pronën që do të shpronësohet nuk është bërë me ndonjë synim apo qëllim diskriminues. I tërë procesi i shpronësimit të pronave të paluajtshme, duke filluar nga aplikimi për shpronësim nga ana e Promovuesit të Projektit e deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar për shpronësim, sipas Nenit 10 dhe 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, zhvillohet brenda një periudhe deri në maksimum 28 javë.

## 6.2 Autorizimi për ndërtimin e infrastrukturës së re

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, autorizimi për ndërtimin e sistemeve të reja për transportin dhe shpërndarjen e gazit, duke përfshirë interkoneksionet, linjat e drejtpërdrejta të energjisë elektrike, tubacionet direkte të gazit për transportin e gazit natyror bien nën kompetencat të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë së Kosovës. Legjislacioni detyësor për autorizim, i cili duhet të miratohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, përcakton kushtet për aplikim dhe kriteret e tjera që duhet të përmbushen nga Promovuesi i Projektit. Autorizimi për ndërtim, siç parashihet në Nenin 4.5 të këtij Doracaku të Procedurave, është vendimi i fundit që merret nga Promovuesi i Projektit.

### 6.2.1. Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme

Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka miratuar Procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme. Rregulla përcakton procedurën e autorizimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, për kapacitetet e mëdha gjeneruese, si dhe për kapacitetet e vogla gjeneruese, duke u bazuar në teknologjinë e ripërtëritshme. Kjo Rregull nuk përfshin procesin e autorizimit për ndërtimin e sistemeve të reja për transportin dhe shpërndarjen e gazit, duke përfshirë interkoneksionet, linjat e drejtpërdrejta të energjisë elektrike, tubacionet direkte të gazit për transportin e gazit natyror.

Rregulla përcakton procedurën në dy faza, përkatësisht fazën paraprake dhe fazën përfundimtare të autorizimit. Autorizimi paraprak lëshohet nëse verifikohet se aplikanti e ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, por që aplikanti ende nuk i ka përmbushur kërkesat e tjera që dalin nga legjislacioni tjetër në fuqi në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. Me t'u lëshuar autorizimi paraprak, aplikanti i ka 12 muaj për të nxjerrë të gjitha lejet e tjera. Autorizimi përfundimtar lëshohet kur aplikanti t'i ketë nxjerrë të gjitha lejet e tjera përkatëse sipas ligjeve përkatëse. Me t'u lëshuar autorizimi përfundimtar, aplikanti ka kohë për të ndërtuar impiantin sipas planit kohor të investimit.

### 6.2.2. Autorizimi për ndërtimin e infrastrukturës së energjisë elektrike dhe infrastrukturës së gazit natyror

Zyra e Rregullatorit të Energjisë duhet të miratojë legjislacionin sekondar për ndërtimin e sistemeve të reja për transportin dhe shpërndarjen e gazit, duke përfshirë interkoneksionet, linjat e drejtpërdrejta të energjisë elektrike dhe tubacionet direkte të gazit për transportin e gazit natyror.

## 6.1 Infrastruktura e gazit

Organizimi dhe funksionimi i sektorit të gazit natyror, qasja në treg, kriteret dhe procedurat e zbatueshme për dhënien e autorizimeve për transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, përdorimin

dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe funksionimi i sistemeve rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-082 për gazin natyror. Kosova nuk posedon infrastrukturë të gazit natyror dhe legjislacion sekondar për zbatimin e Ligjit për Gazin Natyror është miratuar vetëm pjesërisht.

#### 6.3.1. Siguria e furnizimit me gaz natyror

Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2017 për Sigurinë e Furnizimit me Gaz Natyror, të nxjerrur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka për qëllim përcaktimin e masave për sigurinë e furnizimit me gaz natyror si dhe rregullat që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse të nivelit adekuat të sigurisë së furnizimit duke siguruar funksionimin e duhur dhe të vazhdueshëm të tregut të brendshëm të gazit natyror.

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ vlejné për të gjitha autoritetet kompetente në tregun e gazit natyror që planifikojné të marrin masat për të garantuar furnizim të sigurtë dhe të qëndrueshëm me gaz natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit me gaz natyror. Siguria e furnizimit me gaz natyror është përgjegjësi e përbashkët e ndërmarrjeve të gazit natyror në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për sektorin e energjisë në Kosovë.

#### 6.3.2. Licencimi i aktiviteteve të gazit natyror

Rregulla për licencimin e aktiviteteve energjetike në Kosovë (Rregulla: Nr. 07/2017) përcakton procedurën e aplikimit për licencim për zhvillimin e aktiviteteve energjetike në Kosovë, duke përfshirë aktivitetet e furnizimit me gaz natyror. Zyra e Rregullatorit të Energjisë është përgjegjëse për lëshimin e licencës për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin dhe furnizimin e gazit natyror, duke përfshirë transitin, importin ose eksportin e gazit natyror, furnizimin me shumicë (tregtimin), funksionimin e tregut të gazit natyror.

Licencat për zhvillimin e aktiviteteve të furnizimit me gaz natyror i kanë afatet dhe vlefshmërinë si në vijim:

- për aktivitetet e transmetimit të gazit natyror, ose shpërndarjes së gazit natyror, ose depozitimit të gazit natyror, në bazë të jetëgjatësisë së aseteve të përdorura për zhvillimin e aktiviteteve përkatëse me një gjatësi maksimale prej dyzet (40) viteve;
- për aktivitetet e furnizimit të gazit natyror, ose të operatorit të një tregu të organizuar, në bazë të rrethanave financiare të aplikantit me një gjatësi maksimale prej njëzet e pesë (25) viteve;
- për aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Transmisionit ose Shpërndarjes, nëse kryhen ndaras nga aktivitetet e transmisionit ose shpërndarjes, në bazë të jetëgjatësisë së aseteve të përdorura për zhvillimin e aktiviteteve përkatëse me një gjatësi maksimale prej tridhjetë (30) viteve;
- për aktivitetet e furnizimit me shumicë (tregtinë) të gazit natyror nëse janë të licencuar veçmas, në bazë të rrethanave financiare të aplikantit, por jo më shumë se pesë (5) vite dhe jo më pak se një (1) vit.

Kohëzgjatja e çdo licence mund të vazhdohet për një periudhë që nuk tejkalon periudhën përkatëse të kohës së specifikuar më sipër, me kusht që i licencuari të përmbushë të gjitha detyrimet dhe kërkesat e tij sipas licencës, dhe të ketë dorëzuar një kërkesë me shkrim për vazhdimin e saj. Kërkesa për vazhdimin e licencës duhet të paraqitet jo më vonë se gjashtë (6) muaj përpara datës së skadimit të licencës.

### 6.3.2. Pajisjet nën presion

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, Promovuesi i Projektit, duke përfshirë prodhuesi, importuesi, shpërndarësi, përdoruesi dhe instaluesi i pajisjeve nën presion, janë përgjegjës për zbatimin e procedurave që ofrojnë garanci për sigurinë e pajisjeve dhe instalimeve nën presion, si dhe për kushtet esenciale të sigurisë.

Dispozitat e Ligjit për pajisjet nën presion parashikojnë kushtet dhe kërkesat themelore të sigurisë që duhet të zbatohen për projektim, prodhim, vlerësim të konformitetit, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe instalimeve nën presion, që i nënshtrohen një presioni punues manometrik të lejuar më të lartë 0.5 bar. Pajisjet dhe instalimet nën presion, para vënies në treg duhet të pajisen me deklaratë të konformitetit dhe shenjën “CE” e lëshuar nga prodhuesi përfshirë numrin identifikues të trupit të notifikuar i cili ka qenë i kyçur në fazën e prodhimit.

## 6.2 Infrastruktura e energjisë elektrike

Ligji Nr. 04/L-081 për Energjinë Elektrike, përcakton përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës të tregut në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, si dhe përcakton parimet për vendosjen e rregullave të përbashkëta për prodhimin, transmisionin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin dhe tregun e organizuar, si pjesë e tregjeve rajonale dhe evropiane të energjisë.

Operatori i sistemit, i licencuar nga Rregullatori, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike miraton një pjesë të legjislacionit sekondar.

### 6.4.1. Kodi i Rrjetit të Transmisionit

Kodi i Rrjetit të Transmisionit të Energjisë Elektrike zhvillohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike, dhe miratohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës. Kodi i rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike përfshin procedurat operative dhe parimet që rregullojnë ndërveprimet midis operatorit të sistemit të transmisionit dhe përdoruesve të sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë.

Kodi i Rrjetit të Transmisionit të Energjisë Elektrike përmban:

- Kodi i Planifikimit;
- Kodi i Kyçjes;
- Kodi i Planifikimit Operacional;
- Kodi i Balancit;
- Kodi i Operativ;
- Kodi për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë.

### 6.4.2. Licencimi i aktiviteteve të energjisë elektrike

Rregulla për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë (Rregulla: Nr. 07/2017) përcakton procedurën e aplikimit për licencim për zhvillimin e aktiviteteve energjetike në Kosovë, duke përfshirë aktivitetet e furnizimit me energji elektrike. Zyra e Rregullatorit të Energjisë është përgjegjëse për lëshimin e licencës për transmisionin e energjisë elektrike, shpërndarjen e energjisë elektrike, furnizimin me energji elektrike, duke përfshirë transitin, importin ose eksportin e energjisë elektrike, furnizimin me shumicë (tregtimin) e energjisë elektrike, funksionimin e tregut të energjisë elektrike, si dhe operimin e sistemit të transmisionit dhe sistemit të shpërndarjes për energji elektrike.

Licencat për zhvillimin e aktiviteteve të furnizimit me energji elektrike i kanë afatet dhe vlefshmërinë si në vijim:

- për aktivitetet e gjenerimit, transmissioinit të energjisë elektrike ose shpërndarjes së energjisë elektrike, në bazë të jetëgjatësisë së aseteve të përdorura për zhvillimin e aktivitetit përkatës me një gjatësi maksimale prej dyzet (40) viteve;
- për aktivitetet e furnizimit me energji elektrike, ose operatorit të një tregu të organizuar, në bazë të rrethanave financiare të aplikantit me një gjatësi maksimale prej njëzet e pesë (25) viteve;
- për aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Transmissioinit ose Shpërndarjes, nëse kryhen ndaras nga aktivitetet e transmissioinit ose shpërndarjes, në bazë të jetëgjatësisë së aseteve të përdorura për zhvillimin e aktiviteteve përkatëse me një gjatësi maksimale prej tridhjetë (30) viteve;
- për aktivitetet e furnizimit të garantuar me energji elektrike, në bazë të rrethanave financiare të aplikantit me një gjatësi maksimale prej tri (3) viteve;
- për aktivitetet e furnizimit me shumicë (tregtimin) të energjisë elektrike nëse janë të licencuar veçmas, në bazë të rrethanave financiare të aplikantit, por jo më shumë se pesë (5) vite dhe jo më pak se një (1) vit.

Kohëzgjatja e çdo licence mund të vazhdohet për një periudhë që nuk tejkalon periudhën përkatëse të kohës së specifikuar më sipër, me kusht që i licencuari të përmbushë të gjitha detyrimet dhe kërkesat e tij sipas licencës, dhe të ketë dorëzuar një kërkesë me shkrim për vazhdimin e saj. Kërkesa për vazhdimin e licencës duhet të paraqitet jo më vonë se gjashtë (6) muaj përpara datës së skadimit të licencës.



## VII. Palët kryesore të interesit

Palët kryesore të interesit do të ndryshojnë varësisht prej projektit individual PECE/PMI (energji elektrike, nafta, gazi, etj.) dhe varësisht prej lokacionit(-ve) specifik të përfshirë.

Promovuesit e Projektit duhet të tentojnë të identifikojnë palët kryesore të interesit të përfshira, duke kontaktuar Autoritetin Kompetent (One-Stop-Shop) dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe çdo organ tjetër, siç përcaktohet në legjislacion, dhe duke identifikuar grupet përkatëse lokale dhe komunitare të interesit që mund të ndikohen në fushat relevante. One-Stop-Shop, si Autoritet Kompetent, do të japë këshilla lidhur me palët e interesit në fazën e para-aplikimit (pas konsultimit me autoritetet e tjera përkatëse, nëse konsiderohet që duhet). Emrat aktual dhe detajet aktuale të kontaktit do të jenë çështje që Promovuesit e Projektit t'i vërtetojnë ato para çdo aplikimi.

Një link i autoritetit të përshkruar për konsultim sipas Ligjeve përkatëse për mjedis, ndërtim dhe planifikim hapësinor është në dispozicion [këtu](#).

Një link i Ministrisë përgjegjëse për sektorin e Energjisë është në dispozicion [këtu](#).

Një link i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është në dispozicion [këtu](#).

Një link i autoriteteve lokale është në dispozicion [këtu](#).

Një link i Gazetës Zyrtare të republikës së Kosovës është në dispozicion [këtu](#).

Detajet e palëve kryesore të interesit do të zgjerohen kur të përditësohet Doracaku i Procedurave.

## VIII. Hollësitë e dokumenteve për aplikime

Hollësitë e kërkuara për të aplikuar për një zhvillim të propozuar i cili është konsideruar si zhvillim strategjik i infrastrukturës, janë dhënë në faqen e internetit të Komunitetit të Energjisë, e cila është në dispozicion [këtu](#).

One-Stop-Shop, si Autoritet Kompetent, do të identifikojë qëllimin e materialit dhe nivelin e detajeve të informatave që duhet t'i dorëzohen vetvetes në lidhje me një aplikim planifikimi dhe (pas bashkëpunimit të ngushtë me autoritetet e tjera në fjalë dhe, kur është e përshtatshme, në bazë të propozimit nga Promovuesi i Projektit) qëllimin dhe nivelin e detajeve që duhet t'i ofrohen autoriteteve të tjera.

Listat e kontrollit zakonisht mund të merren duke u konsultuar me faqet përkatëse të internetit të autoriteteve në fjalë, të dhëna në Kapitullin VII të këtij Doracaku. Për orientim më të lehtë, linku i regjistrimit qendror të lejeve dhe licencave është në dispozicion [këtu](#).

## IX. Detajet e kontaktit

### 9.1 Autoriteti Kompetent: One-Stop-Shop

Organizata dhe faqja e internetit	Emri	Adresa elektronike	Detajet e kontaktit
Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Divizioni për Standarde dhe Rregulla Teknike  <a href="http://mzhe-ks.net/en/home">http://mzhe-ks.net/en/home</a>	Bashkim Pllana  ose  Mehmet Qelaj	<a href="mailto:bashkim.pllana@rks-gov.net">bashkim.pllana@rks-gov.net</a>  <a href="mailto:mehmet.qelaj@rks-gov.net">mehmet.qelaj@rks-gov.net</a>	Tel: +383 (38) 200 215-65  Adresa: Sheshi "Zahir Pajaziti", Nr.36 10000 Prishtinë, Kosovë

### 9.2 Autoritetet tjera\*

Organizata dhe faqja e internetit	Emri	Adresa elektronike	Detajet e kontaktit
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit-drejtori  Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis/Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale  <a href="http://www.mmph-rks.org/en-us/Home">http://www.mmph-rks.org/en-us/Home</a>	Muhamet Malsiu	<a href="mailto:muhamet.malsiu@rks-gov.net">muhamet.malsiu@rks-gov.net</a>	Tel: +381(0) 38 211-683 +381(0) 38 200 32 517  Adresa: Ish ndërtesa Rilindja, 10 000, Prishtinë, Kosovë;
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Divizioni i ndërtimit-drejtori  <a href="http://www.mmph-rks.org/en-us/Home">http://www.mmph-rks.org/en-us/Home</a>	Servet Spahiu	<a href="mailto:servet.spahiu@rks-gov.net">servet.spahiu@rks-gov.net</a>	Tel: +381(0) 38 200 32 042 +381(0) 38 200 32 517  Adresa: Ish ndërtesa e Rilindjes, 10 000, Prishtinë, Kosovë;
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Instituti për Planifikim Hapësinor  <a href="http://www.mmph-rks.org/en-">http://www.mmph-rks.org/en-</a>	Luan Nushi	<a href="mailto:Luan.Nushi@rks-gov.net">Luan.Nushi@rks-gov.net</a>	Tel: +381(0) 38 200 32 517  Adresa: Ish ndërtesa e Rilindjes,

Organizata dhe faqja e internetit	Emri	Adresa elektronike	Detajet e kontaktit
<a href="#">us/Home</a>			10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës;
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Departamenti i Shpronësimit  <a href="http://www.mmph-rks.org/en-us/Home">http://www.mmph-rks.org/en-us/Home</a>	Afrim Murati	<a href="mailto:Afrim.Murati@rks-gov.net">Afrim.Murati@rks-gov.net</a>	Tel: +381(0) 38 200 32 517  Adresa: Ish ndërtesa Rilindja, 10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës;
Zyra e Rregullatorit të Energjisë - Departamenti Ligjor dhe për Licencim  <a href="http://www.ero-ks.org/w/index.php/en/home">http://www.ero-ks.org/w/index.php/en/home</a>	Afrim Ajvazi	<a href="mailto:legal-licensing@ero-ks.org">legal-licensing@ero-ks.org</a>	Tel: +381 (38) 247 615 loc. 114, 118, 117  Adresa: Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12 Prishtinë 1000, Kosovë
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Divizioni për Toka Bujqësore  <a href="http://www.mbpzhr-ks.net/en/home">http://www.mbpzhr-ks.net/en/home</a>	Idriz Gashi	<a href="mailto:Idriz.gashi@rks-gov.net">Idriz.gashi@rks-gov.net</a>	Tel: +381 38 211-129  Adresa: Sheshi Nënë Tereza, p/n Prishtinë 1000, Kosovë
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Departamenti për Trashëgimi Kulturor  <a href="http://www.mkrs-ks.org/?page=2,1">http://www.mkrs-ks.org/?page=2,1</a>	Vjollca Aliu	<a href="mailto:Vjollca.Aliu@rks-gov.net">Vjollca.Aliu@rks-gov.net</a> <a href="mailto:info@mkrs-ks.org">info@mkrs-ks.org</a>	Tel: +381 38 211 516  Adresa: Sheshi Nënë Tereza, p/n Prishtinë 1000, Kosovë
KOSTT - Departamenti për Zhvillim të Rrjetit dhe Projekteve  <a href="http://www.kostt.com/website/">http://www.kostt.com/website/</a>	Alban Imeri	<a href="mailto:Alban.Imeri@kostt.com">Alban.Imeri@kostt.com</a> <a href="mailto:info@kostt.com">info@kostt.com</a>	Tel: + 383 (0) 38 501 301 106  Rr. Isa Boletini Nr.39 10000 Prishtinë Kosovë

\* Vini re se mund të përfshihen edhe autoritete tjera kur të përditësohet Manuali.